



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

## Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Besim Ilazi, Kryetar i Komunës  
Adresa: Rr."Qamil Ilazi ", Kaçanik, Republika e Kosovës

## 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

### Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut (Komuna e Kaçanikut), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Kaçanikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komuna e Kaçanikut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Theksimi i Çështjes

- 1 Komuna me vendime gjyqësore gjatë vitit 2020 kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 334,268€ në kategori ekonomike joadekuate. Prej tyre 295,784€ ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve të cilat i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve si shujta dhe shpërblime jubilarë; dhe 38,484€ ishin paguar nga mallrat dhe shërbimet për shpronësimin e tokave e të cilat i takojnë kategorisë së investimeve kapitale.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kaçanikut.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kaçanikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kaçanikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kaçanikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kaçanikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalljet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike<sup>4</sup>



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

## 2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Çështjet për pasqyrat financiare

#### Çështja A1 - Shpalosje jo e plotë e të hyrave dhe detyrimeve kontingjente në PFV

**Gjetja** Sipas nenit 21 të Rreg.nr.01/2017 për Raportim vjetor financiar nga OB - Organizatat buxhetore raportojnë shumën e të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak, pranimet gjatë vitit fiskal që kanë qenë në dispozicion për shpenzime gjatë periudhës së raportimit; si dhe bilancin e pa shpenzuar në fund të periudhës raportuese, si dhe neni 18, parasheh se "Organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente".

Në PFV 2020 tek neni 21 raporti për të hyrat vetanake të pashpenzuara, shuma e mbetur për bartje është nënvlerësuar për 130,512€, pasi që nuk ishin paraqit të hyrat indirekte (të hyrat nga dënimet e policisë, gjobave të gjykatave dhe të hyrave nga agjencioni i pyjeve). Të hyrat e bartura të prezantuara në PFV ishin 375,840€, ndërsa shuma për bartje do duhej të ishte 506,352€. Po ashtu, te neni 18 vlera e detyrimeve kontingjente të pazgjdhura të vitit 2019 nuk ishin bartur në kolonën e vitit 2020.

Kjo kishte ndodhur pasi që të hyrat indirekte nuk evidentohen në SIMFK dhe kujdesit jo të duhur gjatë përpilimit të pasqyrave.

**Ndikimi** Mos prezantimi dhe shpalosja e të hyrave indirekte dhe detyrimeve kontingjente ndikon në nënvlerësimin e kategorive përkatëse dhe si rrjedhojë edhe në shpalosje jo të drejtë të tyre në Pasqyra Vjetore Financiare.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që informatat e shpalosura në PFV në lidhje me të hyrat indirekte dhe detyrimet kontingjente janë të plota dhe konsistente nëpër vite.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



## 2.1.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2020 ishin në vlerë 561,138€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte rënie të të hyrave për 16,054€ krahasuar me vitin 2019 për shkak të situatës së pandemisë me Covid 19. Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte në shumë 130,512€, prej tyre të hyrat nga gjykatat 7,370€, dënimet në trafik 112,120€ dhe nga agjencia e pyjeve 11,022€.

### Çështja A2 - Mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore

#### Gjetja

Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës. Po ashtu, sipas nenit 31, pika 6, Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar. Ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Nga 9,034 prona të evidentuara në bazën e të dhënave (objekte), komuna në vitin 2020 kishte arritur të inspektoj 1,199 apo 13% e pronave të paluajtshme; dhe
- Nga gjithsej 129 ankesa të shqyrtuara nga komuna (67 objekte dhe 62 parcela) në lidhje me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë në 122 raste ishin aprovuar në favor të tatimpaguesve. Shqyrtimi i këtyre ankesave në dy raste\* ishte bërë me vonesë, duke tejkaluar afatin ligjor për shqyrtim deri në pesë muaj.

Verifikimi jo i plotë i pronave dhe trajtimi me vonesë i ankesave kishin ndodhë edhe për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19, duke pasur parasysh se një kohë zyrtarët kanë qenë në izolim, pastaj është punuar me reduktime.

#### Ndikimi

Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë. Vonesat në trajtimin e ankesave ndikojnë në mos azhurnimin e informatave në kohë për vlerësimin e duhur të tatimi në pronë.

#### Rekomandimi A2

Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, Kryetari duhet të shtojë kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësimi i saktë i tatimit në pronë për taksa paguesit, dhe në raste të ankesave të mundshëm ato të shyrtohen brenda afateve ligjore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja C1 - Regjistrim i të hyrave në kode jo adekuate ekonomike****Gjetja**

Sipas nenit 44.1 të LMFPP përcakton që- Zyrtaari Kryesor Financiar-ZKF i organizatës buxhetore, do të regjistrojë të gjitha transaksionet dhe do të mbaj regjistrat kontabël në përputhje me aktet nënligjore, gjithashtu sipas procedurave të MFK-së Nr.7, pika 6.1. Zyrtaari Kryesor Financiar (ZKF) është përgjegjës për: pika 6.1.3 (ii) “Rakordimin e të hyrave në SIMFK me faturat dhe pasqyrat bankare”. Ne identifikuam se si rezultat i regjistrimit jo adekuat të të hyrave nëpër kode ekonomike kemi diferenca të të hyrave sipas të hyrave reale dhe atyre të regjistruara në SIMFK:

- Të hyrat nga taksa për leje ndërtimi në SIMFK ishin 83,196€, ndërsa sipas të dhënave nga drejtoria e urbanizmit janë 40,132€;
- Të hyrat nga taksa për legalizimin e objekteve në SIMFK ishin 2,156€, ndërsa sipas të dhënave nga drejtoria e urbanizmit janë 14,156€; dhe
- Të hyrat nga lejet mjedisore komunale në SIMFK ishin 988€, ndërsa sipas të dhënave nga drejtoria e urbanizmit janë realizuar 5,561€.

Kjo ka ndodh pasi që gjatë regjistrimit në SIMFK nuk i është kushtuar kujdes i duhur regjistrimit të tyre nëpër kodet përkatëse që i takojnë.

**Ndikimi**

Mangësitë e identifikuara rezultojnë me pasqyrim jo të drejtë të të hyrave sipas kodeve ekonomike dhe shpalosje të pa saktë të tyre në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi C1**

Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të financave se drejtoritë që mbledhin të hyra bashkëpunojnë ngushtë me zyrtarin e të hyrave në mënyrë që të eliminohen këto gabime dhe të hyrat të regjistrohen në SIMFK sipas kodit përkatës të të hyrave në pajtim me planin kontabël.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,119,663€, prej tyre ishin shpenzuar 1,654,079€ apo rreth 78% të buxhetit final. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e realizuara për asfaltimin e rrugëve lokale, kanalizime, shpronësime. Ne kemi testuar 17 mostra për teste substanciale në shumë 336,477€, si dhe 2 mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e kontratës

##### Gjetja

Sipas nenit 61.23 të Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Ne identifikuam se për projektin "Zgjerimi i rrugës Avdurrahim Shehu" e nënshkruar me 23.07.2020 në vlerë prej 199,935€, menaxheri i kontratës kishte aprovuar ndryshime të pozicioneve të kontratës pa një aprovim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ si në vijim:

- Sasitë sipas specifikacionit teknik të pozicioni 8" Furnizimi dhe vendosja e asfaltbetonit me trashësi prej 6 cm, përpunimin e trotuarit me gjerësi 1.40m" ishin 2016m<sup>2</sup> ndërsa sipas librit ndërtimor ishin realizuar 1836m<sup>2</sup> apo 180m<sup>2</sup> më pak. Këto ndryshime ishin bërë me aprovim nga menaxheri i kontratës por jo edhe Zyrtari Kryesor Administrativ. Në situacionin përfundimtar ky pozicion ishte kalkuluar për pages si i plotë.
- Po ashtu, për këtë kontratë ishte nënshkruar edhe aneks kontrata, ku gjashtë pozicione kishin pësuar ndryshime të theksuara të sasive përkundër që vlera totale e aneks kontratës nuk kishte ndryshuar.

Sipas zyrtarëve përgjegjës ndryshime janë bërë për shkak problemeve pronësore dhe për tu përshtatur nevojave të situatave të terrenit apo kërkesave të qytetarëve

##### Ndikimi

Mangësitë në menaxhimin e kontratave zvogëlojnë sigurinë që kontratat janë duke u realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikat e kontratës dhe ndikojnë në kualitetin e punimeve. Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit mund të rezultojë me pagesa të parregullta dhe vlerë të ulët për para.

##### Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe menaxheri i kontratës duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave dhe sa herë që paraqitet nevoja për ndryshime të kontratës të bëjë kërkesë për aprovim të ndryshimeve duke arsyetuar kërkesën për ndryshim dhe marrë aprovimet e duhura.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.1.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV-të e vitit 2020 ishte 76,146,828€, kurse e pasurive jokapitale 592,512€. Ne testuam 70 mostra për teste substanciale në vlerë 1,275,058€. Poashtu kemi vlerësuar procesin e përgjithshëm të menaxhimit të pasurive, inventarizimin e pasurive dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pasurive të komunës.

### Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosjen e informatave në PFV

#### Gjetja

Rregullorja MF-nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton qartë rregullat dhe procedurat për menaxhimin e pasurive dhe stokeve dhe aktiviteteve në lidhje me inventarizimin e pasurive. Ne kemi identifikuar mangësi në menaxhimin e regjistrave dhe shpalosjen e tyre në PFV si në vijim:

- Komuna kishte formuar komisionin për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive dhe hartuar raportin e përgjithshëm të inventarizimit, mirëpo nuk e kishte harmonizuar me regjistrin kontabël dhe PFV;
- Pasuritë e blera nën 1,000€ gjatë vitit 2020 nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria. Shpalosja e pasurive jo kapitale në PFV ishte bërë sipas vlerës së vitit paraprak duke mos e përfshirë zhvlerësimin dhe blerjet e vitit aktual. Sipas evidencave të thesarit shpenzimet (kodet e pasurive nën 1,000€) për vitin 2020 ishin në shumë 60,466€;
- Pasuria e cila ka të bëjë me investimet kapitale në dy shkolla në vlerë 40,252€ "Projekti auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje tjera të obligueshme" e theksuar edhe në raportin e auditimit 2019 ende nuk ishte regjistruar në regjistra, duke e nënvlerësuar pasurinë për këtë vlerë; dhe
- Në raportin e auditimit 2019 ishte identifikuar se tre (3) kamion me vlerë prej 45,000€ të blerë me bashkëfinancim të komunës, Kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastërtia" dhe Shoqërisë Gjermane për bashkëpunim ndërkombëtarë sh.p.k (GIZ), nuk ishin regjistruar plotësisht. Pjesa e paguar nga bashkëfinancuesit prej 22,000€ ende nuk ishte regjistruar dhe për këtë vlerë kemi një nënvlerësim të pasurisë së komunës.

Sipas zyrtarëve të komunës sistemi i e-pasurisë ka qenë jo funksional dhe nuk kanë mundur të gjenerojnë raportet e pasurive. Evidenca interne nuk janë mbajtur për të pasur një pasqyrë të saktë të pasurive nën 1,000€.

#### Ndikimi

Menaxhimi i dobët i pasurive ka ndikuar në shpalosjen jo të saktë të pasurive e që për pasojë kemi një nënvlerësim të pasurive në PFV. Mangësitë e identifikuar, po ashtu ndikojnë që menaxhmenti të mos ketë informatat e sakta për gjendjen e pasurive që janë në dispozicion të komunës duke i vështirësuar marrjen e vendimeve të duhura për investime të reja për pasuri.

**Rekomandimi C2** Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme në mënyrë që sistemi e-pasuria të jetë funksional. Po ashtu duhet të mbahen evidenca që tregojnë se regjistrat e pasurive janë të plotë dhe saktë duke siguruar që vlera e prezantuar e pasurive nën 1,000€ në PFV shpalos vlerën reale të pasurive me të cilën disponon komuna.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,569,211€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,315,108€, taksa e bizneseve 228,710€ dhe qiraja prej 25,391€.

### Çështja B1 - Rritja e Llogarive të Arkëtueshme dhe shpalosje jo e saktë e tyre në PFV

#### Gjetja

Rregullorja nr. 01/2017 Për Raportim Vjetor Financiar, neni 16, obligon organizatat buxhetore që mbledhin të hyra që të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave”.

Të arkëtueshmet krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 105,056€. Kjo rritje ishte kryesisht te tatimi në pronë për shkak të situatës pandemike, por që një shumë të madhe të këtyre llogarive janë të ndikuara nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të menaxhuara/privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Problemet janë kryesisht me ndërmarrjet e privatizuara që kanë mbet borxh duke iu shtuar kamata dhe interesi. Vetëm borxhi i AKP për tatimin në prone është me vlerë prej 115,744€.

Në PFV 2020 janë shpalosur LLA nga shfrytëzimi i pronës publike në shumë 25,391€ ku janë vërejtur diferenca në bartjen e saldove\*. Po ashtu, komuna nuk na ka ofruar informacione mbi gjendjen e të arkëtueshmeve nga shfrytëzimi i pronës publike që ishin dërguar te përmbartuesi në vlerë prej 45,966€.

Mungesa e një sistemi dhe neglizhenca për të përcjellur gjendjen e saldove dhe lëndëve përmbartimore ka shkaktuar që regjistrat mos të jenë të plotë, dhe të saktë. Po ashtu si pasojë e vitit pandemik, komuna nuk ka marr masa ligjore për arkëtimin e tyre.

#### Ndikimi

Mungesa e shënimeve të sakta të LLA, ndikojnë në pasqyrimin jo të vërtetë të këtyre llogarive dhe shpalosjen jo të saktë të tyre në PFV. Po ashtu mund të ndikojnë në humbjen e të dhënave dhe inkasimin e tyre. Përderisa rritja e LLA nëpër vite, dhe mos inkasimi i tyre, ndikon në përkeqësimin e performancës buxhetore të komunës.

**Rekomandimi B1** Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të sigurojë nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen me një kujdes të veçantë nëpër vite. Çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore duhet të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit/arkëtimit të tyre bazuar në marrëveshjet e arritura me tatimpaguesit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>a</sup>	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>9,000,531.00</b>	<b>9,662,835.67</b>	<b>9,025,465.65</b>	<b>8,111,517.40</b>	<b>7,811,293.67</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	8,289,804.00	8,601,486.22	8,499,060.77	7,346,663.95	7,157,204.45
Financimi përmes huamarrjes	0.00	73,780.00	66,825.00	38,481.44	19,286.07
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	263,423.10	145,987.40	258,549.19	169,558.32
Të hyrat vetanake	710,727.00	710,727.00	302,733.98	461,817.82	374,106.83
Donacionet vendore	0.00	13,419.35	10,858.50	6,005.00	7,000.00
Donacionet e jashtme	0.00	0.00	0.00	0.00	84,138.00

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 662,305€, kjo rritje ishte kryesisht nga programi i rimëkëmbjes ekonomike dhe fondi i pakos fiskale qeveritare në shumë 364,654€, të hyrat vetanake 263,442€, Grantet e përcaktuara të donatorëve në shumë 13,419€ dhe burimet e tjera të financimit 20,790€.

Komuna e Kaçanikut ka shpenzuar 93% të buxhetit final apo 9,025,466€, në raport me vitin e kaluar kemi nivel po thuajse të njëjtë të realizimit të buxhetit (2019 - 94%) Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.



**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>9,000,531.00</b>	<b>9,662,835.67</b>	<b>9,025,465.65</b>	<b>8,111,517.40</b>	<b>7,811,293.67</b>
Pagat dhe mëditjet	5,120,807.00	5,232,500.11	5,232,500.09	4,959,251.73	4,925,423.06
Mallrat dhe shërbimet	920,000.00	1,822,159.80	1,725,418.34	824,637.75	823,679.38
Komunalitë	170,000.00	197,600.00	183,232.58	140,475.77	110,317.73
Subvencionet dhe transferet	206,540.00	290,912.50	230,235.16	215,417.82	306,772.19
Investimet Kapitale	1,944,139.00	2,119,663.26	1,654,079.48	1,971,734.33	1,645,101.31
Rezervat	639,045.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë ekonomike janë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 111,693€ i cili ishte shpenzuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 902,160 € i cili ishte shpenzuar në masën prej 95%. Buxheti ishte rritur si rezultat i ndarjeve buxhetore për mbulimin e shpenzimeve të Covid 19 dhe nga rezerva. Po ashtu, edhe buxheti final për komunalit ishte rritur për 27,600€ i cili ishte shpenzuar në masën prej 93%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 84,373€ i cili ishte shpenzuar në masën prej 79%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 175,524 € i cili ishte shpenzuar në masën prej 78%; Mos realizimi i buxhetit në nivel me të lartë ishte për shkak të mungesës së bilancit të pamjaftueshëm bankar në llogari të thesarit ;


Si rezultat i situatës pandemike Covid-19 komuna kishte shpenzuar 474,528€ për këtë qëllim. Prej tyre 183,540€ shtesa në paga, 283,488€ mallra dhe shërbime dhe 7500€ në subvencione dhe transfere.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe paga dhe mëditje kishin trend të rritjes me të lartë se kategoritë tjera në vitin aktual krahasuar me vitet paraprake ndërsa për investime kapitale shpenzimet në vitin aktual ishin më të ulëta krahasuar me vitin 2019.

Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Nga Shpenzimet e përgjithshme vetëm për paga dhe mëditje ishin shpenzuar 58% ndërsa 42% të shpenzimeve ishin për kategoritë tjera ekonomike të realizuara gjatë vitit 2020.

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2020 ishin në vlerë 561,138€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte rënie të të hyrave për 16,054€ krahasuar me vitin 2019 për shkak të situatës së pandemisë me Covid 19. Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte në shumë 130,512€, prej tyre të hyrat nga gjykatat 7,370€, dënimet në trafik 112,120€ dhe nga agjencia e pyjeve 11,022€.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>710,727.00</b>	<b>710,727.00</b>	<b>561,138.31</b>	<b>577,191.67</b>	<b>498,501.66</b>
Të hyrat tatimore	362,885.00	362,885.00	263,486.88	293,013.49	244,906.63
Të hyrat jo tatimore	347,842.00	347,842.00	297,651.43	284,178.18	253,595.03

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të komunës së Kaçanikut ka rezultuar në 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, 5 (pesë) rekomandime janë zbatuar 1 (një) nuk është adresuar ende, 2 (dy) pjesërisht dhe 2 (dy) nuk aplikohen më, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet me përpikëri sipas kodeve ekonomike adekuate. Po ashtu të gjitha obligimet duhet të paguhen me kohë në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore	Pagesat për vendime gjyqësore nuk janë bërë nga kategoritë adekuate, por kjo çështje do të trajtohet në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë.	Nuk është i aplikueshëm më

2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj hartimin e procedurave të shkruara për dhënien e pronave në shfrytëzim afatshkurtër, siç e parasheh ligji. Po ashtu para se të nënshkruhen kontratat e reja të gjithë qiramarrësit/shfrytëzuesit e pronave duhet ti kryejnë obligimet paraprake kontraktuale	Janë marre veprime për hartimin e procedurave për dhënien e pronave me qira	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që drejtorja e urbanizmit dhe zyrtari i të hyrave të kryejnë barazime mujore të evidencave. Është e nevojshme që për çdo pronë të lëshuar me qira të mbahen evidenca/kartela financiare	Për evidencat e qirave nuk kemi identifikuar mangësi përderisa diferencat në të hyrat e regjistruara në SIMFK dhe regjistrat e brendshëm të drejtorive janë evidente.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike	Nuk është identifikuar ndonjë rast në testimet e tona.	I zbatuar
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të vendosë kontrolle shtesë në procesin e ndarjes së subvencioneve, për të siguruar se kriteret në thirrjet publike për aplikim të jenë specifike dhe të qarta, dhe të sigurohet se subvencionimi paraprihet me marrëveshje e cila bën të mundur edhe monitorimin e shpenzimit të këtyre mjeteve.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur ndonjë rast të tillë.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet jashtë planit të prokurimit do të njoftohen organet kompetente, si dhe të përgatiten projektet ekzekutive si pjesë e specifikave teknike të projekteve, në mënyrë që të lehtësohet edhe realizimi i tyre konform kontratave	Nga mostrat e testuar nuk kemi hasur ndonjë rast të tillë.	I zbatuar

7.	Pasuritë	Kryetari duhet të inicojë aprovimin e rregullave të brendshme për menaxhimin e pasurive për të qartësuar secilin aktivitet që lidhet me menaxhimin e pasurive. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës (përfshirë pasuritë kapitale dhe jo kapitale) janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtim me kërkesat ligjore	Një pjesë e pasurive, ishin regjistruar ( "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Biqec" me vlerë prej 18,628€ përderisa çështja e Shpronësimit në vendin e quajtur "Nerodime", kishte një aktgjykim nga Gjykata supreme në fund të vitit 2020 e ku kontesti ishte zgjidhur në favor të komunës së Kaçanikut. Po ashtu sistemi e - Pasuria nuk ishte funksional.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të sigurojë nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen me një kujdes të veçantë nëpër vite. Çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore duhet të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit/arkëtimit të tyre bazuar në marrëveshjet e arritura me tatimpaguesit	Komuna nuk ka evidencë të plota dhe sakta për llogaritë e arkëtueshme	Nuk është adresuar
9.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha obligimet e mbetura/papaguara në fund vit të raportohen saktë në PFV.	Nuk kemi hasur ndonjë rast të tillë	I zbatuar
10.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitën e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi	Plani i auditimit të brendshëm ishte përbushur dhe menaxhmenti nuk e kishte vlerësuar të nevojshme plotësimin me staf shtesë, si rezultat i mungesës së pozitave të aprovuara.	Nuk është i aplikueshëm më

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që informatat e shpalosura në PFV në lidhje me të hyrat indirekte dhe detyrimet kontingjente janë të plota dhe konsistente nëpër vite.
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të financave se drejtoritë që mbledhin të hyra bashkëpunojnë ngushtë me zyrtarin e të hyrave në mënyrë që të eliminohen këto gabime dhe të hyrat të regjistrohen në SIMFK sipas kodit përkatës të të hyrave në pajtim me planin kontabël.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, Kryetari duhet të shtojë kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësimi i saktë i tatimit në pronë për taksa paguesit, dhe në raste të ankesave të mundshëm ato të shyrtohen brenda afateve ligjore.
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe menaxheri i kontratës duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave dhe sa herë që paraqitet nevoja për ndryshime të kontratës të bëj kërkesë për aprovim të ndryshimeve duke arsyetuar kërkesën për ndryshim dhe marrë aprovimet e duhura.
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme në mënyrë që sistemi e-pasuria të jetë funksional. Po ashtu duhet të mbahen evidenca që tregojnë se regjistrat e pasurive janë të plotë dhe saktë duke siguruar që vlera e prezantuar e pasurive nën 1,000€ në PFV shpalos vlerën reale të pasurive me të cilën disponon komuna.
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të sigurojë nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen me një kujdes të veçantë nëpër vite. Çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore duhet të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit/arkëtimit të tyre bazuar në marrëveshjet e arritura me tatimpaguesit.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Udhëheqës i Auditimit



Bahri Statovci, Udhëheqës i ekipit



Selvete Foniqi, Anëtare e ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit





## Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna Kaçanik - Municipality of Kaçanik

Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020  
dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Kryetari Besim Ilazi

Kryetar komune ZKA

Data: 05.korrik.2021



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>9</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>10</sup> Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> 8,765€, vlera e pazgjidhur që nuk është bart.
- <sup>6</sup> Ankesa për pronën nr P-70917048 dhe pronen nr. 107102
- <sup>7</sup> Për kontratën IPKO Telecommunications tek LLA ka paraqit parapagim shumë 3,600€ e që sipas shënimeve duhet të jetë 1,800€. Për Kontratën me Ismet Tali ka paraqit LLA shumë 2,614€ e që sipas shënimeve duhet të jetë 1,364€.
- <sup>8</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>9</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>10</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.